



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE



REVISTË,

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NR. 4, TIRANË 2018



FOKUS — MBROJTA E PUNËS SË GAZETARËVE SI GARANCI PËR NJË MEDIA TË LIRË

RREGULLIMI LIGJOR NË MARRËDHËNIET E PUNËS SË GAZETARËVE NË
TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), zhvilluan, në muajin maj, tryezën e diskutimit mbi “Rregullimin ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive”.

Ka kohë që për çështjen e rregullimit të marrëdhënieve të punës në mediat audiovizive janë të njohura problematikat e hasura, si niveli i kushteve të punës së gazetarëve, format e rekrutimit dhe largimit nga redaksia, mosshlyerja në kohë e pagesave nga punëdhënësi, organizimi ose jo i gazetarëve në shoqata, funksionaliteti i tyre etj.

Për këtë arsye, Komisioni Parlamentar dhe AMA organizuan një tryezë ku ishin të ftuar përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit: gazetarë, drejtues mediash, anëtarë të parlamentit, profesorë të gazetarisë, përfaqësues nga shoqatat e organizatat e gazetarëve dhe nga institucionet shtetërore që mbulojnë aspekte të punësimit etj.

Në tryezë pati qëndrime të ndryshme nga folësit, por e përbashkëta ishte se tashmë, pas rreth 28 viteve nga fillimet demokratike në vend, ka ardhur koha për veprime konkrete për të siguruar lirinë e medias. Pa një gazetar të sigurt në punë nuk mund të kemi media të lirë dhe pluraliste, u tha nga diskutantët.

Për Kryetarin e AMA-s, z. Gentian Sala, është shumë i rëndësishëm standardi i burimeve njerëzore për lirinë dhe integritetin e medias audiovizive. Ai evidentoi faktin se, nga organizatorët e tryezës, priteshin propozime konkrete në lidhje me adresimin e problemeve, të cilat do të ishin gur themeli për ushtrimin e lirë të profesionit të gazetarit në vend. AMA, në këtë tryezë diskutimi, dha garancinë që do të bëjë ç’është e mundur në rrugë ligjore, në bashkëpunim me gjithë aktorët e tjerë institucionalë, që të rregullojë kushtet e punës dhe, shumë shpejt, gazetarët do të kenë



në dorë kontratën tip si fillim dhe më vonë kontratën kolektive.

Znj. Albana Vokshi, Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, dha nga ana e saj mbështetjen se Komisioni është vullnetplotë që të ndihmojë në përmirësimin e punës së gazetarëve në vend. Znj. Vokshi siguroi për solidaritet me gazetarët, duke qenë se ata janë rojtarët e shtetit të së drejtës. Ajo denoncoi rastet kur gazetarët, sipas saj, kanë qenë të censuruar dhe dha alarmin se gazetaria investigative është në kushte jo të mira. Ajo theksoi se një gazetar me punë të keqregulluar është një vegël në duart e pushtetit. Znj. Vokshi kërkoi nga institucionet kompetente monitorimin e punës së gazetarëve dhe transparencë nga ana e mediave, të cilat janë punëdhënëse. Palët me ndikim duhet t’i kapërcejnë agjendat politike

dhe të kenë vullnet për të siguruar media të lirë, përsëriti në tryezë znj. Vokshi.

Znj. Milva Ekonomi, zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në ndërhyrjen e saj, theksoi mungesën e organizmave sindikale nga ana e gazetarëve, por ajo argumentoi se kjo shkon bashkë me një organizim të dobët që kanë në përgjithësi sindikatat në Shqipëri. Modeli i ri i mediave nuk të jep hapësirë për pavarësi editoriale dhe për këtë duhet të ndërhyhet në ligjet që kanë lidhje direkt me punën e gazetarëve, në të njëjtën kohë duke forcuar edhe rolin e Inspektoriatit të Punës.

Shefi i Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, z. Claus Neukirch, përmendi se produkti mediatik është puna e gazetarëve. Puna e tyre është, në mënyrë të pashmangshme, e

ndikuar nga kushtet e punës. Ai nënvizoi se institucionet shtetërore dhe aktorët mediatikë kanë për detyrë sigurimin e këtyre kushteve minimale, për të pasur, më pas, një media më të shëndetshme, të pavarur dhe të lirë. Z. Neukirch tha se Këshilli i Evropës do të mbështesë iniciativën të tillë si ajo e AMA-s dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Më tej, z. Musa Ulqini, anëtar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, vuri theksin se kontrata tip dhe ajo kolektive duhet të ishin qëllimi i tryezës; po ashtu edhe krijimi i një sindikate për të ndjekur modelin italian apo edhe të vendeve të tjera perëndimore, duke krijuar edhe Urdhrin e Gazetarëve. Znj. Eda Beqiri, nga Inspektoriatit i Punës, tha se ekziston vetëm një Vendim i Këshillit të Ministrave, duke iu referuar Vendimit nr.



358, datë 25.03.1996, i cili rregullon punën e gazetarit. Ajo ofroi bashkëpunim për përmirësimin praktik të këtij kuadri rregullator. Drejtori i Programeve në AMA, z. Arben Muka, prezantoi treguesit konkretë të burimeve njerëzore të angazhuara, të cilat autoriteti i bën transparent për publikun në versionin print ose online.

Nga ana tjetër, z. Mark Marku, nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në UT, tha se Departamenti krijon premisa për gazetarë të mirë, por ai nuk krijon gazetarët, ata krijohen duke ushtuar profesionin në redaksi, prandaj kushtet e punës janë të rëndësishme për të krijuar gazetarë të mirë dhe, për rrjedhojë, media cilësore.

Si nga z. Blendi Salaj, nga Qendra Media Aktive, ashtu edhe nga z. Armand Shkullaku, nga Shoqata e Gazetarëve Profesionistë, u ngritën

problemet e punës së gazetarëve në punën e tyre të përditshme. Mosshlyerja e pagave në kohë, mungesa e kontratave tip dhe atyre kolektive, mungesa e Urdhrit të Gazetarit, ndërrimi i shpeshtë i stafit të redaksisë pa arsye të argumentuara, paga minimale, mungesa e përshkrimeve të punës, oraret e zgjatura tej kushteve njerëzore në punë, janë ndër shkaqet praktike dhe të prekshme që pse Shqipëria ka akoma probleme me lirinë e medias dhe integritetin e saj. Këto mendime u përkrahën edhe nga pedagogia e gazetarisë dhe komunikimit, znj. Iris Luarasi, si dhe nga zëvendëskryetari i AMA-s, z. Sami Nezaj.

Në përfundim të tryezës u ra dakord se, brenda muajit maj 2018, AMA do të pasqyroste në një material të përmbledhur të gjitha propozimet dhe sugjerimet konkrete të Tryezës, në mënyrë që ato të adresohen për shqyrtim dhe rrugëzgjdhje në institucionet përkatëse.



FOKUS — RESPEKTIMI I LIGJIT PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE

TAKIMI AMA-AKEP PËR RRITJEN E EFIKASITETIT NË LUFTËN KUNDËR PIRATERISË TELEVIZIVE

Në muajin maj, AMA organizoi një takim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në prani dhe të operatorëve Digitalb, Tring dhe ABCom, mbi fenomenin e piraterisë televizive.

Në një kohë kur pirateria televizive është një fenomen në rritje, u theksua gjatë

takimit, konsiderohet si i domosdoshëm një koordinim më efikas mes institucioneve që mbikëqyrin tregun audioviziv dhe atë të komunikacionit, si dhe me operatorët PayTV që preken direkt nga ky aktivitet i jashtëligjshëm. Nga pjesëmarrësit u evidentua fakti se zhvillimet teknologjike në fushën e telekomunikimit kanë bërë më të lehtë



piratimin e përmbajtjeve audiovizive, si dhe kanë vështirësuar veprimtarinë e organeve përgjegjëse për konstatimin dhe eliminimin e këtij fenomeni.

Takimi u vlerësua për qëllimin që konsiston në rritjen e bashkëpunimit mes dy autoriteteve, operatorëve audiovizive dhe ofruesve të shërbimit të internetit, në rritjen e

efikasitetit të luftës kundër piraterisë televizive nëpërmjet një koordinimi gjithëpërfshirës dhe një procesi të mirëregulluar, përmes të cilit garantohen rezultate konkrete.

Diskutimet e këtij takimi pritet të konkretizohen me nënshkrimin e një memorandumit bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces.



MBROJTJA E FËMIJËVE NË SHËRBIMET E MEDIAS AUDIOVIZIVE - SFIDAT DREJT SË ARDHMES

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave, si një nga strukturat kryesore të Autoritetit, organizuan, në muajin janar, tryezën e rrumbullakët me temë “Mbrotjtja e fëmijëve në shërbimet e medias audiovizive – sfidat drejt së ardhmes”.

Pjesë e kësaj tryeze ishin përfaqësues të televizioneve, Komisionit Parlamentar të Medias, Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale, Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, organizmave ndërkombëtarë, Institutit Shqiptar të Medias, studentë të gazetarisë etj.

Tryeza e rrumbullakët, që erdhi fill pas miratimit të *Kodit të ri të Transmetimit*, synoi të promovojë kulturën e mbrotjtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive e të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të gjithë aktorëve të interesuar mbi këtë çështje. Nga ana tjetër, kjo tryezë tregoi gatishmërinë e



të gjithë aktorëve për të nxitur dhe zbatuar rregullat etike të Kodit të Transmetimit dhe të përmirësojë cilësinë e përmbajtjes së prodhimeve audiovizive.

Për Kryetarin e AMA-s, z. Gentian Sala, fokusi kryesor i AMA-s është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. “Kemi një situatë më të mirë, por ‘mjaft’ nuk është asnjëherë”, tha kreu i AMA-s.

Ndërsa znj. Monika Stafa, kryetare e Këshillit të Ankesave, pasi vuri në dukje bashkëpunimin e mirë dhe efikas të kësaj strukture me organizatat në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, shpjegoi arsyet pse fëmijët janë në vëmendjen kryesore të vetë AMA-s dhe Këshillit të Ankesave: “Sepse edhe numri më i lartë i ankesave të mbërritura në Këshill lidhen pikërisht me shkeljen e të drejtave dhe privatësisë së fëmijëve”.

Zëvendësministria e Arsimit, znj. Besa Shahini, theksoi se është shumë e rëndësishme t’i mbrojmë fëmijët nga *fake news*, si edhe nga edhe ekspozimi i dëmshëm mediatik. Edukimi mediatik dhe rëndësia e përfshirjes në kurrikula e këtij orientimi mbeten ende sfida të institucioneve të cilat kanë fokus fëmijët.

Këshilltarja e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Alma Sulstarova, foli në emër të zëvendësministres, znj. Bardhylka Kospiri, dhe theksoi disa nga problematikat e publikimit të informacioneve në media që i bën fëmijët të identifikueshëm. Pasojat e këtyre publikimeve bien mbi fëmijët, theksoi në fjalën e saj dhe përfaqësuesja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve, znj. Anila Bregu, e cila shtoi se bazuar në risitë ligjore mbi median duhen propozuar ndryshime në



kurrikulën e arsimit për studentet e gazetarisë.

Më tej, pjesëmarrësit në tryezë diskutuan për mbrojtjen sociale të fëmijëve, bashkëpunimin me institucionet, problemet e evidentuara që kërkojnë adresim dhe zgjidhje, edukimin për mediat dhe fëmijët, praktikat më të mira të raportimeve mediatike, si dhe përmirësimet ligjore në fushën e të drejtave të fëmijëve. Edhe pse situata, sipas tyre, është përmirësuar sa u përket raportimeve

mediatike, që kanë fëmijët në qendër të tyre, ata sollën në vëmendje raste kur janë shkelur të drejtat e fëmijëve dhe privatësia e tyre.

Në fund të takimit u sugjerua që rekomandimet e tryezave të tilla t’u përcillen edhe redaksive, gazetarëve dhe redaktorëve në mënyrë që të kenë parasysh rregullat etike dhe, nga ana tjetër, të jetë objektiv trajnimi i vazhdueshëm i gazetarëve për ligjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe normat apo parimet etike.



FOKUS – RESPEKTIMI I LIGJIT PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE

EDUKIMI PËR MEDIAN: “TAKIM I GRUPIT TË EKSPERTËVE – KOORDINIMI DHE SINERGJITË MES PALËVE PËR NJË KOMUNIKIM TË PËRGJEGJSHËM ETIK

Në muajin maj, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave organizoi tryezën e rrumbullakët me temë “Edukimi për Median: Takim i grupit të ekspertëve – Koordinimi dhe sinergjitë mes palëve për një komunikim të përgjegjshëm etik”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi konceptin paraprakisht se çfarë është në thelb edukimi mediatik. Mprehja e shqisës kritike te qytetari kundrejt një prodhimi lajmesh e ndodhish në këtë bum teknologjik platformash të ndryshme. Nevoja

e përfshirjes së *Edukimit Mediatik* si lëndë më vete në kurrikulat mësimore mbetet një kërkesë emergjente që mund të vetërregullojë në mënyrë të drejtë dhe profesionale efektet e medias në jetën e njeriut dhe sidomos të fëmijëve.

Pjesë e kësaj Tryeze të Rrumbullakët, që pati një mbështetje të vazhdueshme nga autoritetet e AMA-s, ishin anëtarët e Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, përfaqësues të televizioneve, organizmave ndërkombëtarë, Institutit Shqiptar të Medias, studentë të gazetarisë etj.

Zëvendëskryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive, z. Sami Nezaj, duke diskutuar për praktikën rregulluese dhe vetërregulluese, politikat, strategjitë dhe legjislacionin lidhur me edukimin në media, nënvizoi disa momente kyçe, që burojnë nga Kushtetuta e Shqipërisë (nenet 22 dhe 23) dhe nga ligji për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Për z. Nezaj, ky i fundit ka qasje periferike për edukimin në media, por ka disa momente që mund të perceptohen lidhur me edukimin në media, si p.sh., Këshilli i Ankesave.

Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Luçiano Boçi, anëtar i Komisionit Parlamentar për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik, tha se edukimi mediatik, edukimi i shoqërisë, ndërgjegjësimi i saj mund të konsiderohen prioritet. Sipas tij, lëndë të veçanta për edukimin mediatik duhet të ishin përfshirë tashmë në kurrikulat shkollore. Nëse disa vende i kanë me zgjedhje lëndë të tilla, për deputetin Boçi, në Shqipëri duhet të jenë të detyrueshme. Znj. Almira Xhembulla, gjithashtu anëtare e Komisionit Parlamentar Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, theksoi nevojën për analizë të audiencës, por dhe të produktit

që i ofrohet asaj. Ajo përmendi orientimin e Komisionit Evropian sa i përket edukimit në media dhe theksoi nevojën për të ecur edhe më tej me këtë detyrë.

Ndërsa znj. Dorianë Dervishi, këshilltare në kabinetin e Ministrit të Arsimit Rinisë dhe Sporteve, solli një panoramë të gjerë mbi kurrikulat shkollore, universitare por dhe parauniversitare. Sipas saj, ka institucione të arsimit të lartë, që kanë përfshirë module për gazetarinë dhe median, pra për edukimin mediatik. Pyetja është, shtoi znj. Dervishi, a duhen shtrirë këto module edhe në arsimin parauniversitar? Si shembuj të punës së vazhdueshme të Ministrisë së Arsimit në këtë fushë ajo solli projektin pilot për edukimin për fenë, si dhe modulet për të drejtën e informimit apo edukimin ekonomik në arsimin bazë.

Ilda Londo, nga Instituti Shqiptar i Medias, u ofroi të pranishmëve në këtë tryezë disa të dhëna nga indeksi mbi median në Shqipëri. Ajo nënvizoi dy momente kryesore të këtij indeksi: i pari, që Shqipëria renditet ndër vendet më të papërgatitura lidhur me edukimin në media dhe i dyti, që publiku ka ende një shkallë të lartë besimi tek media në Shqipëri.

Për zëvendësdrejtoreshën e Bibliotekës Kombëtare, znj. Etleva Domi, duhet një strategji kombëtare për edukimin mediatik, me pjesëmarrjen e shumë institucioneve, pasi në kohët e sotme, interneti dhe zhvillimet teknologjike diktojnë nevojën për një qasje të re ndaj kësaj teme.

Ndërsa z. Ramadan Çipuri, nga Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, tha se roli i universiteteve për edukimin në media është parësor. Po aq parësor sa dhe bashkëpunimi me mediat e institucioneve të tjera. Ai parashtoi disa sugjerime në funksion të përmirësimit të situatës së medias në vend. Anëtarja e Bordit të AMA-s, znj. Suela Musta, solli rezultatet e një monitorimi të

kryer prej saj për tri televizione, Klan, Top Channel dhe Vizion +, rreth spektakleve *show* që këto televizione transmetojnë. Sipas saj, janë vërejtur shkelje flagrante të Kodit të Transmetimit, sidomos ndaj imazhit të fëmijëve dhe keqpërdorimit të tyre ku fëmijët po përdoren për qëllime aspak të drejta.

Për ekspertin e medias, z. Rrapo Zguri, jemi në epokën e konsumit të informacionit, ku gjithçka është e digjitalizuar, lehtësisht e riprodhueshme dhe e manipulueshme. Ndaj, shtoi ka, ka ardhur koha që të hapet një debat i gjerë: Ku fillon media?

Z. Erald Kapri, anëtar i Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, solli në vëmendjen raportin e fundit të fondacionit “Soros”, ku Shqipëria renditet e parafundit për edukimin mediatik, si dhe shtjelloi mënyrat dhe mekanizmat shqiptarë për përfshirjen dhe edukimin e publikut. Znj. Karolina Risto, drejtore ekzekutive e InTV, duke sjellë përvojën e saj si gazetare, dhe tashmë si drejtuese, foli për disa rrugë e mënyra se çfarë mund të bëjë media për të nxitur edukimin e publikut për informacionin. Sipas saj, duhen ndërmarrë iniciativa edhe për të përmirësuar profesionalizmin në media dhe për të zhvilluar mekanizma vetërregullues, si një mënyrë për të bashkëpunuar me publikun. Monika Stafa, Kryetare e Këshillit të Ankesave, në fjalën e saj nënvizoi, ndër të tjera, se që në krye të herës duhet të shpjegojmë se çfarë domethënë *edukim mediatik*. Ky term, i njohur gjerësisht si *Media Literacy* nënkupton që konsumatori i medias duhet të jetë në gjendje të bëjë disa pyetje lidhur me sa lexon *online* apo sheh në televizion. Ai duhet të dijë, më së pari, se cila media është burimi i informacionit e, më tej, kush është/janë pronarët e saj dhe ç’interesa kanë ata. Si konsumator i lajmeve qytetari duhet të mësohet të bëhet më kërkuar, shtoi më tej Stafa, sepse aty ku burimet mungojnë dhe “faktet” kalojnë pakontrolluar, ka gjithmonë potencial për propagandë, keqinformim dhe abuzim.



Këshilli i Ankesave në AMA do të mirëpresë nisma të tilla, duke ftuar të gjithë partnerët ndërinstitucionalë për të bashkëpunuar në këtë çështje, së fundmi, aq të ndjeshme për të ardhmen e fëmijëve tanë.


Në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në muajin prill, u zhvillua tryeza e diskutimit: “Respektimi i standardit të shqipes në transmetimet audiovizive”. Kjo temë u trajtua në funksion të respektimit të standardit të folur dhe të shkruar të shqipes

në përmbajtjet audiovizive. Çështja e respektimit të rregullave të gjuhës shqipe ka kohë që është bërë shqetësuese në radio dhe televizione.

Zëvendëskryetari i AMA-s, z. Sami Nezaj, përshëndeti aktivitetin dhe i ftoi mediat e pranishme të bëheshin proaktive në respektimin e gjuhës shqipe, duke e cilësuar përdorimin e kësaj të fundit në kushte emergjence.

Nga dyshqyrtime tematike që ka zhvilluar AMA kohët e fundit, u evidentuan problematika në respektimin e normave të standardit të shqipes nga televizionet kombëtare dhe ato informative, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në audiencë; kjo vihet re edhe në transmetimet radiofonike.

Disa nga çështjet kryesore, që ishin vënë re, u janë bërë të ditura dhe vetë OSHMA-ve të monitoruara, që ishin në fokus të diskutimit dhe pjesë aktive e tryezës.



AMA ZHVILLON TRYEZËN E DISKUTIMIT “RESPEKTIMI I STANDARDIT TË SHQIPES NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE”



Një studim shumë interesant u paraqit nga Prof. Asoc. Linda Mëniku, pedagoge pranë Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë. Znj. Mëniku theksoi, në punimin e saj, se emergjenca për përdorimin e saktë të gjuhës na ka trokitur të gjithëve në derë dhe secili nga aktorët duhet të bëjë pjesën e tij për moszhvillimin e kësaj dukurie. Znj. Mëniku i ilustroi me shembuj

konkretë të gjitha shkeljet në rrafshin e përdorimit të gjuhës shqipe në median audiovizive.

Edhe mediat e pranishme e pranuan situatën dhe treguan vullnet për të përmirësuar mjedisin gjuhësor në mediat përkatëse. Përfaqësues nga Radio “Kontakt”, televizioni “Vizion Plus”, Radio Televizioni Shqiptar,

Platforma “Tring”, Televizioni “Klan” etj., u bënë pjesë aktive e tryezës duke dhënë mendime sesi mund të përmirësohet kjo gjendje. Gabimet në drejtshkrim e drejtshqiptim, përdorimi i gabuar i shenjave të pikësimit, përdorimi i pavend i fjalëve të huaja, përkthimet e pasakta të filmave dhe dublimet e shtrembëruara, u ngritën, po ashtu si probleme, nga të pranishmit në tryezë.

AMA, gjatë muajit qershor dhe korrik, vijoi me organizimin e tryezave të diskutimit mbi respektimin e standardit të gjuhës shqipe në transmetimet audiovizive edhe me operatorët e qarkut Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Korçë, me qëllim ndërgjegjësimin e operatoreve rajonalë mbi përdorimin e saktë të gjuhës dhe, gjithashtu, mbi ligjin për median në Shqipëri.





FOKUS – MATJA E AUDIENCËS

AMA HEDH HAPIN E PARË PËR RREGULLIMIN E MATJES SË AUDIENCËS NË SHQIPËRI



Me zhvillimin e industrisë televizive, gjatë viteve, funksioni i hulumtimit të audiencës ka shërbyer për të ndihmuar industrinë e transmetimit dhe reklamimit që të zhvillohet dhe rritet, përmes informacionit dhe gjetjeve, për sa i përket sjelljes së audiencës në përzgjedhjen e programacionit televiziv, si edhe treguesve, sa i përket tregtisë së kohës televizive në funksion të industrisë së reklamave.

Pa ekzistencën e një sistemi të pavarur matjeje, si palë e tretë, i cili, adopton standardet më të larta të saktësisë dhe integritetit, tregu i televizioneve nuk do të mund të funksiononte në mënyrë të efektshme.

Me qëllimin që ky treg të jetë sa më transparent AMA organizoi, në muajin shkurt, takimin e parë konsultativ për rregullimin e audiencës. Në fokus të aktivitetit rregullator

të AMA-s, matja e audiencës televizive, është një aspekt mjaft i rëndësishëm për rregullimin e tregut audioviziv dhe bën pjesë në grupin e veprimtarive që AMA organizon, mbështet dhe promovon në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në tryezën e organizuar nga AMA ishin të ftuar të gjitha palët e interesit, televizionet kombëtare dhe rajonale, shoqatat dhe agjencitë e komunikimit, kompanitë e reklamave, dhe kompanitë që matin audiencën.

Nisma e marrë nga AMA u përshëndet nga të gjitha palët e ftuara. Ata e cilësuan këtë hap të nevojshëm dhe rregullimin e tregut të matjes së audiencës të domosdoshëm.

Përfaqësuesit e televizioneve u shprehën se

është koha që në Shqipëri të ketë një kompani, e cila të jetë e certifikuar dhe të ketë besimin e të gjitha palëve në integritetin e saj; të tjerë ndanë mendimin se tregu ka nevojë për një matje profesionale të audiencës të pranuar nga të gjithë, sepse kështu rregullohet tregu i reklamave. Kurse përfaqësues të kompanive të reklamave thanë se do të jetë me vend dhe e domosdoshme edhe një konsulencë e huaj në lidhje me draftimin e propozimeve të specializuara sipas nevojave të tregut.

Qëndrimi i Shoqatës së Agjencive të

Komunikimit kërkonte më shumë transparencë dhe ndërtimin e një sistemi që të përfaqësojë të gjitha palët. Tregu duhet të vetërregullohet, por atij, natyrisht që duhet t'i vendosen standarde. Pra, media është dakord që shteti duhet të supervizojë por të mos përfshihet. Fryma që mbizotëroi nga të pranishmit ishte ajo e një kërkesë për krijimin e një standardi të ri edhe të besueshëm.

Kjo tryezë do të pasohet së shpejti nga një e dytë, e cila do të paraqesë propozime konkrete.



FOKUS – PARTNERITETI I AMA-S

TAKIM PUNE AMA-OSBE MBI DINAMIKAT E TREGUT AUDIOVIZIV NË SHQIPËRI

Zhvillimet në spektrin audioviziv, roli dhe angazhimi i AMA-s si institucion rregullator dhe kontributi e mbështetja e OSBE-së në garantimin e lirisë dhe pavarësisë së medias, ishin çështjet kryesore që u diskutuan mes kryetarit të Autoritetit, z. Gentian Sala dhe z. Harlem Désir, përfaqësuesi i lartë i OSBE-së për lirinë e medias. Ky takim ndodhi në muajin shkurt, në mjediset e AMA-s, në Tiranë. Z. Désir dhe delegacioni që e shoqëronte u interesuan

mbi kushtet e punës dhe problemet e gazetarëve në Shqipëri, vijimin e procesit të dixhitalizimit dhe impakti tek operatorët e te publiku i gjerë, marrëdhëniet e AMA-s me Transmetuesin Publik apo subjektet e tjera private etj. Mungesa, në Shqipëri, e instrumenteve për matjen e audiencës, e lidhur kjo dhe me procesin e ndarjes së reklamës në operatorë të ndryshëm, ishte një tjetër temë mbi të cilën u diskutua në takim.



AMA PRET DELEGACIONIN E AUTORITETIT MAQEDONAS TË MEDIAVE



Në muajin mars, Autoriteti i Mediave Audiovizive priti delegacionin maqedonas të Agjencisë së Medias për Shërbimet Audio dhe Audiovizive, i ardhur për vizitë zyrtare në Shqipëri.

Kryetari i AMA-s, z. Gentian Sala dhe stafi mirëpritën z. Lazo Petrusevski, Kryetar i Këshillit të Agjencisë, z. Milaim Fetaj, Zëvendës-president i Agjencisë, z. Arben Saiti, Shef i Departamentit të Mbështetjes së Informacionit dhe Çështjeve të Përgjithshme, z. Agron Ademi, Koordinator i zyrës për Marrëdhëniet me Publikun.

Në takimin e mbajtur mes palëve u diskutuan çështje me rëndësi për të dy Autoritetet, si shkëmbimi i ndërsjellë i informacionit mes dy Autoriteteve, trendet e zhvillimit të medias, risitë e teknologjisë në rajon dhe më gjerë, kuadri rregullator në funksion të matjes së audiencës, dhe u shkëmbyen, gjithashtu, përvojat në lidhje me procesin e dixhitalizimit të transmetimeve.

Autoriteti maqedonas ndau eksperiencën e tij në fushën e programacionit, mënyrat e monitorimit dhe sfidat, si të teknologjisë ashtu edhe të burimeve njerëzore.

Z. Sala, gjatë vizitës, e njohu delegacionin me proceset e punët në të cilat AMA është përfshirë aktualisht.

Një pikë tjetër e diskutimeve mes dy përfaqësive ishte edhe bashkëpunimi për kuadrin rregullator të transmetimeve.

Z. Lazo Petrusevski, Presidenti i Këshillit të Agjencisë, u tregua i gatshëm të forcojë bashkëpunimin midis dy institucioneve homologe, që do të kenë edhe shkëmbim studimesh, të realizuara përkatësisht nga secili prej Autoriteteve rregullues.

Shumë shpejt ky takim i parë në Tiranë do të vazhdojë edhe më tej me hapa konkretë, dhe një memorandum bashkëpunimi pritët të firmoset në muajt në vijim.



AMA PRET DELEGACIONIN E AUTORITETIT GREK TË MEDIAVE



Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive, z. Gentian Sala, priti në një takim pune, më 6 qershor, një delegacion të Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit Grek, NCRTV, ku në përbërje ishin Prof. George Pleios, anëtar i Këshillit dhe znj. Dora Papadaki, eksperte ligjore. Përfaqësuesit e dy institucioneve homologe kanë zhvilluar sistematikisht kontakte në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA etj., por ky ishte takimi i parë zyrtar bilateral mes tyre, iniciuar nga AMA.

Aspekte të strukturimit të dy institucioneve, përshtatja e direktivave evropiane në legjislacionin kombëtar në fushën audiovizive, shqyrtimi i përmbajtjeve të transmetuara dhe procedimi me ankesat mbi shkeljet ligjore, metodologjitë efektive për matjen e audiencës – këto dhe të tjera ishin çështjet ku u ndalën më shumë, në bashkëbisedim, anëtarët e dy delegacioneve. Gjithashtu,

u vlerësua maksimalisht angazhimi për trajtimin e rasteve të mosplotësimit të standardeve për mbrojtjen e fëmijëve në përmbajtjet e emetuar, të reklamave dhe volumit të tyre, të shmangies së gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, të qasjes për veprat evropiane, sidomos nga subjektet me licencë kombëtare etj.

Miq të nga NCRTV vlerësuan përgatitjen dhe publikimin nga AMA të të dhënave nga tregu audioviziv shqiptar, si ato periodike mujore ashtu dhe përmbajtjen e treguesve të Buletinit çdo 6 muaj. Interesi nga pala shqiptare ishte për përvojën e homologëve grekë në përshtatjen e legjislacionit në monitorimin e problematikave që lidhen me të drejtat e njeriut në tërësi, në veçanti për fëmijët. Mundësia e arritjes në një memorandum bashkëpunimi mes dy institucioneve pritet të jetë hapi vijues në kooperimin AMA – NCRTV.

AMA MERR PJESE NË TAKIMIN E 47-TË TË EPRA-S NË LUKSEMBURG



Takimi i 47-të i Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore, EPRA, u zhvillua në Luksemburg, në periudhën 23-25 maj. AMA u përfaqësua nga z. Gentian Sala, Kryetar, znj. Vera Muço, Sekretare e Përgjithshme dhe z. Arben Muka, Drejtor i Programeve.

Dy kolonat e takimit ishin mbi rolin dhe pozicionin e transmetuesve publikë në erën dixhitale, si dhe komunikimi politik përballë efekteve të rrjeteve sociale. Gjithashtu, organizatorët kishin planifikuar dhe seanca të ngushta diskutimi mbi tema të aktualitetit, si ndryshimet e komunikimeve tregtare, diversiteti në përmbajtjet e transmetuara, duke pasur si fokus të veçantë barazinë gjinore, aspekte të respektimit të privatësisë etj.

Përveç pjesëmarrjes në seancat plenare të takimit, përfaqësuesit e delegacionit të

AMA-s u përfshinë në seancat debatuese, në prezantimin e realitetit audio dhe audioviziv në Shqipëri, problematikat dhe perspektivën.

Takimi i 47-të në Luksemburg ishte dhe një rast shumë i mirë për kontakte të drejtpërdrejta, dy a më shumëpalëshe, me përfaqësues të autoriteteve rregullatore të vendeve të tjera. E përbashkëta e këtyre kontakteve ishte shprehja e interesit për të intensifikuar bashkëpunimin për çështjet më të rëndësishme të transmetimeve audiovizive, si mbrojtja e fëmijëve, shmangia e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit të çdo formë, reklamat dhe komunikimet tregtare, edukimi mediatik etj.

Propozimi mbi organizimin e një prej eventeve të radhës, të EPRA-s, në Shqipëri, ishte një tjetër çështje që u diskutua mes delegacionit të AMA-s dhe Sekretariatit teknik të EPRA-s.

AMA PROAKTIVE

AMA KONTRIBUON NË PASURIMIN E PYLLIT ORBITAL





Për AMA-n dhe për stafin e institucionit është shumë e rëndësishme që, përveç kryerjes me përpikëri të detyrave të tij, të kontribuojë edhe për ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme. AMA, prej kohësh, i ka kthyer politikat e gjelbra në prioritet në punën e përditshme, duke filluar nga kursimi i energjisë, mbrojtja e mjedisit dhe kontributi direkt në ndryshimin për mirë të tij.

Në muajin shkurt, AMA iu bashkua aksionit të Bashkisë Tiranë për gjelbërimin e qytetit me dhurimin e 100 pemëve kumbulla të kuqe. Kumbullat e kuqe të dhuruara nga AMA u mbollën pranë liqenit të Farkës, si pjesë e projektit të Pyllit Orbital. Blerja e pemëve u mundësua nga buxheti i stafit të AMA-s.

Duke e cilësuar si një nismë shumë të nevojshme mbjelljen e pemëve, kryetari i AMA-s, z. Gentian Sala, tha se aktiviteti i mbjelljes së pemëve është nga më frymëzuesit ku stafi i AMA-s merr pjesë. Autoriteti ka si

objektiv që politikat mjedisore t'i përkrahë edhe me një fond të vogël në buxhetin e tij të vitit pasardhës.

Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, i shprehu mirënjohjen anëtarëve të stafit të AMA-s, të cilët, me fondet e tyre kontribuuan në shtimin e numrit të pemëve të reja të mbjella këtë sezon, në kryeqytet. Z. Veliaj apeloj që ky shembull i qytetarisë, të ndiqet edhe nga institucionet e tjera, duke lënë në këtë mënyrë një shenjë në krijimin e një ambienti të shëndetshëm për fëmijët.

Parku i Liqenit të Farkës po shndërrohet në një nga hapësirat më çlodhëse, më të vizituara për komunitetin e shtuar të banorëve në këtë zonë, por edhe nga turistët ditorë për aktivitete sportive. Kryebashkiaku Veliaj falënderoi për ndihmën në mbjelljen e 100 pemëve dhe theksoi se kur gjërat e vogla bëhen me dashuri, rezultati është fantastik.



AMA I BASHKOHET PROGRAMIT TË KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR PËR DHURIMIN VULLNETAR TË GJAKUT

Në muajin shkurt, stafi i Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë në pasurimin e bankës së gjakut, program i Kryqit të Kuq Shqiptar, me qëllim sigurimin e gjakut të mjaftueshëm dhe të sigurt në vend.

Stafi i Autoritetit dhuroi gjak në mënyrë vullnetare për t'iu gjendur në nevojë gjithkujt, duke promovuar kështu vlerat humane që përmban dhurimi vullnetar i gjakut, duke e konsideruar atë një aspekt mjaft të rëndësishëm njerëzor për individë dhe grupe të veçanta të komunitetit, si plotësim të nevojave për gjak në vend, dhe si një vlerë e shoqërive të emancipuara.


Motivimi i gjithë shoqërisë për të dhuruar gjak është detyrë e rëndësishme dhe me shumë përgjegjësi, e cila synon ndryshimin e qëndrimeve të njerëzve dhe të sjelljeve të tyre, veçanërisht te moshat e reja. Për këtë arsye “Të marrësh gjak të sigurt është një e drejtë, të dhurosh gjak të sigurt është një akt njerëzor dhe privilegj”. Ky ishte mesazhi që dha stafi i Autoritetit me pjesëmarrjen e tij në këtë fushatë.

Le të përpiqemi së bashku për të dhuruar gjak të sigurt dhe të mjaftueshëm.



FOKUS: FORCIMI DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE





AMA i ka dhënë rëndësinë që i takon trajnimit dhe zhvillimit të stafit në fusha të veçanta të njohurive dhe aftësive, sikurse kërkon funksioni dhe puna që çdo nëpunës civil kryen, në gamën e gjerë të veprimtarisë së institucionit.

Nëkuadërtë zhvillim të aftësive, përmirësimit dhe rritjes së efektivitetit në punë dhe në vijim të kalendarit të analizës së nevojave për trajnim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në bashkëpunim me disa prej njësive organizative në AMA, gjatë gjysmës së parë të vitit 2018, ka organizuar trajnime për të gjithë nëpunësit civilë. Këto trajnime u zhvilluan në trajtën e tryezave të diskutimit ndërmjet nëpunësve civilë të të gjitha niveleve të drejtorive të ndryshme, duke pasur si qëllim:

- Zhvillimin e aftësive, njohurive dhe profesionalizmit të stafit;
- Prezantimin e punonjësve të rinj me funksionet e AMA-s, objektivat dhe legjislacionin në fuqi;
- Rritjen e bashkëpunimit gjatë grupeve të punës;
- Rritje profesionale në përshtatje me aftësitë e fituara.

Gjatë muajit mars 2018, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, zhvilloi trajnimin me temë: “*Shërbimi civil dhe etika në administratën publike*”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte prezantimi i punonjësve të rinj me administratën



publike, por dhe ofrimi i njohurive bazë mbi legjislacionin e shërbimit civil, organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe rregullat e sjelljes për punonjësit e administratës publike.

Po ashtu, për stafin u ofrua *një trajnim i avancuar për ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*. Pajisja e nëpunësve me njohuri të legjislacionit mbi mediat audiovizive, përditësimi i këtyre njohurive, është një faktor i lidhur ngushtë me performancën e çdo nëpunësi.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK, në muajin maj, u zhvillua trajnimi me temë “*Digjitalizimi*”. Nisur nga ecuria e procesit të digjitalizimit, si një proces kompleks, nëpunësit e AMA-s u njohën me fazën aktuale të këtij procesi, sfidat, transmetimet digjitale, pritshmëritë dhe rolin e AMA-s.

Nën asistencën dhe drejtimin e Drejtorisë së Programeve dhe Drejtorisë Juridike dhe Licencave, po ashtu në muajin maj, u prezantuan për të gjithë nëpunësit e AMA-s *ndryshimet ligjore të miratuara të “Kodit të Transmetimit për Median Audiovizive”*.

Nëpërmjet trajnimit u diskutua mbi ndryshimet ligjore të miratuara së fundmi, parimet bazë të transmetimit, parimet dhe rregullat për programet informative, për mbrojtjen e të miturve në programet e të gjitha llojeve, kundër dhunës së skajshme në ekran, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e të dhënave personale e të personave me aftësi të kufizuara etj.

Duke pasur si qëllim standardizimin e praktikave të punës, në muajin qershor, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë organizoi një tjetër trajnim *duke prezantuar dhe njohur gjithë stafin me “Manualin e regjimit të qarkullimit, përpunimit dhe administrimit të dokumentacionit shkresor”*. Ky dokument është një referencë për çdo nëpunës, në punën e tij të përditshme, i cili e orienton mbi mënyrën e qarkullimit të shkresave, përpunimit dhe administrimit të tyre brenda dhe jashtë institucionit, si dhe përcakton qartë rregullat dhe procedurat e miratuara, për të rritur efikasitetin në punë, duke respektuar me përpikëri bazën ligjore në këtë drejtim.







Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.

Cel: +355 67 303 3000

e-mail: Info@ama.gov.al

www.ama.gov.al